L I G J
Nr.8257, datë 19.11.1997

PËR NJË PLOTËSIM NË LIGJIN NR.7561, DATË 29.4.1992 "PËR DISA NDRYSHIME E PLOTËSIME NË LIGJIN NR.7491, DATË 29.4.1991 "PËR DISPOZITAT KRYESORE KUSHTETUESE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në nenin 18, pas paragrafit të tretë shtohen paragrafët e mëposhtëm:

"Zëvendësimi i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese për shkaqet e parashikuara në nenin 23 nuk konsiderohet rotacion.

Me mbarimin e mandatit trevjeçar ose kur vërtetohet një nga shkaqet e parashikuara nga neni 23, zgjedhja ose emërimi I gjyqtarit të ri bëhet brenda 30 ditëve.

Moskryerja e rotacionit pezullon funksionet e Gjykatës Kushtetuese.

Në qoftë se pas kryerjes së rotacionit gjyqtarët e rinj nuk zgjidhen ose emërohen brenda afatit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese funksionon me përbërjen e anëtarëve që i ka mbetur."

Neni 2

Pas nenit 18 shtohet neni 181 me këtë përmbajtje:

"Gjykata Kushtetuese të zhvillojë rotacionin e parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e dekretimit të tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1962, datë 20.11.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani